



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 26

Tiranë – E hënë, 8 gusht 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Urdhër i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 197, datë 22.7.2022	Për shpalljen e kritereve të përzgjedhjes dhe procesit të aplikimit për administratorët e njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVQV-ve që mund të jenë në kushtet e vështirësive serioze financiare apo paaftësisë paguese).....	3
Kërkesë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 295/52, datë 25.7.2022	Për shprehje interesi për pjesëmarrje në <i>Dispute Board</i> , në kuadër të projektit “Reforma e projektit të QSUT-së, faza II # LD 1841 (2014) dhe SDA-7 TA (2014)”, përfituese e së cilës është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.....	3
Njoftim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 3026/1, datë 28.7.2022	Për shpalljen e një vendi vakant për pozicionin e Specialistit të IT-së në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me afat 6 deri në 12 muaj.....	5
Njoftim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 3026/2, datë 28.7.2022	Për shpalljen e një vendi vakant për pozicionin e Specialistit të Financë-Buxhetit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me afat 6 deri në 12 muaj.....	6
Njoftim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 3026/3, datë 28.7.2022	Për shpalljen e një vendi vakant për pozicionin e Specialistit të Sekretarisë Gjyqësore në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me afat 6 deri në 12 muaj.....	7
Njoftim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 3026/4, datë 28.7.2022	Për rishpalljen e një vendi vakant për pozicionin e Specialistit të Financë-Prokurimeve në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.....	7
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 14832, datë 2.8.2022	Për shitje me ankand të pronës shtetërore në administrim të shoqërisë “Vefa” sh.p.k.....	8
Kërkesë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 1195, datë 3.8.2022	Për marrjen me qira të ambienteve për nevoja të sistemimit të punonjësve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.....	9

**URDHËR**

Nr. 197, datë 22.7.2022

**PËR SHPALLJEN E KRITEREVE TË
PËRZGJEDHJES DHE PROCESIT TË
APLIKIMIT PËR ADMINISTRATORËT E
NJËSIVE TË VETËQEVERISJES
VENDORE (NJVQV-ve QË MUND TË
JENË NË KUSHTET E VËSHTIRËSIVE
SERIOZE FINANCIARE APO
PAAFTËSISË PAGUESE)**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; në zbatim të pikës 5, të nenit 59, të ligjit nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”; dhe pikave 157 dhe 171, të udhëzimit nr. 26, datë 27.9.2019, “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, ministri i Financave dhe Ekonomisë

URDHËRON:

1. Shpalljen e kriterëve të përzgjedhjes dhe fillimin e procesit të aplikimit për administratorët e njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVQV-ve që mund të jenë në kushtet e vështirësive serioze financiare apo paaftësisë paguese).

2. Aplikanti për administrator i njësive të vetëqeverisjes vendore duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë arsimuar në shkencat ekonomike ose shkencat juridike (me Master shkencor);

b) të ketë eksperiencë në punë të paktën 10 vjet në administratën publike;

c) të ketë njohuri të thelluara dhe kualifikime në fushën e menaxhimit të financave publike në nivel vendor;

d) nuk duhet të ketë konflikt interesi me njësitë e qeverisjes vendore.

3. Afati i aplikimit të kandidatëve për t'u përzgjedhur në listën e administratorëve të njësive të vetëqeverisjes vendore është 40 ditë pune nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

4. Aplikanti do të dorëzojë në protokollin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet rrugës postare apo dorazi, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesë me shkrim;

b) fotokopje të kartës së identitetit;

c) adresën e vendbanimit, vendit të punës dhe pikave të kontaktit;

d) kopje të diplomës, listës së notave dhe një përmbledhje të edukimit, kualifikimeve dhe eksperiencës së punës;

e) një fotografi të përmasave 4x6;

f) kopje të licencave dhe/ose të certifikatave profesionale në fusha dhe profesione të rregulluara me ligj;

g) dëshmi dhe certifikata të trajnimeve dhe të kualifikimeve pasuniversitare;

h) vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.

5. Ky urdhër publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, shpërndahet nëpërmjet rrugëve elektronike zyrtare dhe botohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare (QBZ).

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

KËRKESË

Nr. 295/52, datë 25.7.2022

**PËR SHPREHJE INTERESI PËR
PJESËMARRJE NË *DISPUTE BOARD*, NË
KUADËR TË PROJEKTIT “REFORMA E
PROJEKTIT TË QSUT-së, FAZA II # LD
1841 (2014) DHE SDA-7 TA (2014)”,
PËRFITUESE E SË CILËS ËSHTË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE**

Punimet civile: Faza II e projektit të reformës së QSUT-së

Subjekti Kontraktor: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë

FTESË PËR BORDIN E ANKESËS

Projekti i Reformës së Qendrës Spitalore Universitare Tiranë (QSUT), faza II # LD 1841 (2014) dhe SDA-7 TA (2014)

1. Republika e Shqipërisë ka marrë një hua nga Banka e Këshillit të Evropës për Zhvillim (CEB) për



ndërtimin e fazës 2 të QSUT-së, në shumën e kontratës përafërsisht 22 milionë euro.

2. Për zbatimin e detyrës së sipërpërmendur, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/Njësia e Zbatimit të Projektit dhe Kontraktori, INSO Albania, synojnë të caktojnë një bord ankese, i cili siç përcaktohet në kushtet e veçanta të Kontratës FIDIC Art. 20.2, do të përbëhet nga tre anëtarë. Dy anëtarët e parë rekomandojnë dhe bien dakord për anëtarin e tretë, i cili do të veprojë si kryetar.

3. Nëpërmjet këtij njoftimi, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si Punëdhënëse, synon të marrë vëmendjen e anëtarit, i cili do të përfaqësojë interesin e punëdhënësit në Bordin e Ankesave (BD).

4. Aplikantët e interesuar dhe të kualifikuar duhet të flasin rrjedhshëm gjuhën e komunikimit të përcaktuar në Kontratë dhe duhet të kenë përvojë profesionale në llojin e kontratës së tillë ndërtimore.

5. Informacione të mëtejshme mund të merren nga: Njësia e Zbatimit të Projektit/Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale gjatë orarit të punës 09:00 deri në orën 15:00, sipas orës lokale të Shqipërisë. Shprehja e interesit, e cila konfirmon kriteret e marra, duhet të dorëzohet në adresën e mëposhtme. Ju lutemi vini re se të interesuarit duhet të dërgojnë konfirmimin e tyre për këtë detyrë brenda 8 ditëve pune nga data e publikimit të këtij njoftimi.

Njësia e Zbatimit të Projekteve/Ministria e Shëndetësisë

Rruga e Elbasanit, pall. "Edil-Al-It", # 205

Personi kontaktues: Enik Shehu, drejtor i PIU-së

Mob.: + 355 68 20 21 148

E-mail: enikshehu@yahoo.com

TERMAT E REFERENCËS

Ministria e Shëndetësisë është në kërkim të një anëtarit të Bordit të Ankesës (DB) për të marrë pjesë në projektin tonë spitalor në vazhdim, sipas kushteve të kontratës në Librin e Kuq FIDIC.

Kërkohet si më poshtë:

Kualifikimi i punës:

- Diplomë universitare në Inxhinieri ose Arkitekturë. Diplomë Master në Inxhinieri/ Arkitekturë ose Drejtësi do të jetë një avantazh.

- Njohuri të avancuara të gjuhës angleze. Të folurit dhe të shkruarit janë një domosdoshmëri.

- Minimumi 20 vjet përvojë pune në industrinë ndërkombëtare të ndërtimit, 10 prej të cilave në përvojën e menaxhimit të kontratave dhe dëmeve, sipas FIDIC-së në ndërtim.

- Përvoja e mëparshme e punës në projekte më të mëdha se 30 milionë euro në buxhet është e domosdoshme. Eksperienca në Shqipëri do të jetë një avantazh.

- Të ketë vepruar si një arbitrazh i emëruar nga Pala dhe mbështetje gjyqësore për mosmarrëveshjet, sipas rregullave të FIDIC-së ndërmjet subjekteve qeveritare dhe kontraktuesit ndërkombëtar.

- Aftësi të demonstruara për të kuptuar dhe për të analizuar kushtet komerciale të kontratave FIDIC.

- Njohuri për analizën e vonesës së planifikimit dhe planifikimit.

Përkthimi i punës:

- Rishikon rekomandimet e projektit dhe siguron vlefshmërinë e kërkesave kontraktuale.

- Ndërlidh me anëtarët e tjerë të DB-së të nevojshme dhe diskuton për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

- Jep mendim për kontratat, pretendimet dhe çështjet e planit.

- Menaxhon procedurat dhe procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

- Prodhon vendime të shkruara me cilësi të lartë, të qarta dhe koncize për referime.

- Organizon dhe merr pjesë në takime dhe dëgjime në terren me anëtarë të tjerë të DB-së dhe përfaqësues, sipas nevojës.

**Civil Works: Phase 2 of Tirana University
Hospital Centre Reform Project
Contracting entity: Ministry of Health and
Social Protection of Republic of Albania
INVITATION FOR DISPUTE BOARD
Albania – Tirana University Hospital
Centre Project (TUHC) Reform, Phase II
Loan # LD 1841 (2014) and SDA-7 TA (2014)**

1. The Republic of Albania has received a Loan from the Council of Europe Development Bank (CEB) for the Construction of the Phase 2 of Tirana University Hospital Centre (TUHC) in the Contracts amount approx. 22 Million Euro.



2. For the implementation of the above mentioned task, the Ministry of Health and Social Protection/Project Implementation Unit and the Contractor, INSO Albania, intend to appoint a Dispute Board which as stated in the particular conditions of the FIDIC Contract Art. 20.2, shall be comprised of three members. The first two members shall recommend and agree upon the third member, who shall act as Chairman.

3. Through this notice the Ministry of Health and Social Protection, as Employer, intends to receive the attention of the member which will represent the interest of the Employer in the Dispute Board (DB).

4. Interested eligible Applicants shall be fluent in the language for communication defined in the Contract and shall be professional experienced in the type of such construction Contract.

5. Further information may be obtained from: Project Implementation Unit/Ministry of Health and Social Protection during office hours 09:00 to 15:00 hours, local Albanian time. The expression of interest which confirm the received criteria must be submitted to the address below. Please note that the interested persons must send their confirmation for this task within 8 working days after the date of publication of this notice.

Projects Implementation Unit/Ministry of Health

Rruga e Elbasanit, pall. "Edil-Al-It", # 205

Contact Person: Enik Shehu, PIU Director

Mob.: + 355 68 20 21 148

E-mail: enikshehu@yahoo.com

TERMS OF REFERENCES

The Ministry of Health is looking for a Dispute Board (DB) member to take part in our ongoing hospital project, under FIDIC Red Book Conditions Of Contract.

The following is required:

Job qualification:

- University degree in Engineering or Architecture. Master's degree in Engineering/Architecture or Law will be an asset.

- Advanced knowledge in English. Both speaking and writing is a must.

- Minimum 20 years of work experience in international construction industry, 10 of which in

contract and claim management experience under FIDIC in construction.

- Previous work experience in projects larger than 30 Million Euros in budget is a must. Experience in Albania will be an asset.

- Acted as a Party-appointed Arbitration and litigation support for dispute under FIDIC rules between government entities and international Contractor.

- Demonstrated ability to understand and analyze commercial conditions of FIDIC contracts.

- Knowledge of planning and scheduling delay analysis.

Job description:

- Review project referrals and ensure validity of contractual requirements.

- Liaise with other DB members necessary and discuss for resolutions of disputes.

- Provide opinion of contracts, claims and schedule issues.

- Manage dispute resolution proceedings and procedures.

- Production of high quality, clear and concise written decisions for referrals.

- Organize and attend site meetings and hearings with other DB members and party representatives as necessary.

NJOFTIM

Nr. 3026/1, datë 28.7.2022

PËR SHPALLJEN E NJË VENDI VAKANT PËR POZICIONIN E SPECIALISTIT TË IT-së NË KOMISIONIN E PAVARUR TË KUALIFIKIMIT ME AFAT 6 DERI NË 12 MUAJ

Në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar, që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Specialistit të IT-së në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: III-b.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

1. Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master shkencor" në Inxhinieri Informatike, Informatikë, Teknologji informacioni etj;



2. Të ketë 2 vjet eksperiencë pune në fushën e teknologjisë së informacionit;

3. Të ketë njohuri shumë të mira në administrimin e sistemeve, si: *Active Directory*, *Outlook Mail Client*;

4. Të ketë njohuri bazë mbi pajisjet e rrjetit dhe infrastrukturën e rrjetit;

5. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;

6. Preferohet të jetë i pajisur me CSP.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t'u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015;

- Ndaj tyre të mos jetë nisur procedim penal, të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale;

- Ndaj tyre të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t'u përshtatur e për të punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;

2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;

3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune) (origjinale ose të noterizuara);

4. Dëshmi penaliteti;

5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

6. Çdo dokumentacion tjetër, që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda datës 31 gusht 2022, pranë Institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, Zyra e Protokollit, nga e hëna–të premte, ora 08:30–17:00, ose nëpërmjet postës elektronike, në adresën: info@kpk.al, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

NJOFTIM

Nr. 3026/2, datë 28.7.2022

PËR SHPALLJEN E NJË VENDI VAKANT PËR POZICIONIN E SPECIALISTIT TË FINANCË-BUXHETIT NË KOMISIONIN E PAVARUR TË KUALIFIKIMIT ME AFAT 6 DERI NË 12 MUAJ

Në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar, që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin vakante të Specialistit të Financë-Buxhetit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: III-b.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) të zotërojnë diplomë të nivelit “Master shkencor” në Ekonomi, dega Financë;

b) të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;

c) të ketë të paktën 2 vjet përvojë pune në profesion;

d) të ketë njohuri në programet financiare, si: Alpha/Financa 5 etj.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidati duhet të plotësojë kriteret për t'u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188 datë 4.3.2015;

- Ndaj tij të mos jetë nisur procedim penal, të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale;

- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;

- Kandidati duhet të kenë aftësi për t'u përshtatur e për të punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidati i interesuar duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;

2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;

3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune) (origjinale ose të noterizuara);



4. Dëshmi penaliteti;

5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.

6. Çdo dokumentacion tjetër, që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda datës 31 gusht 2022, pranë Institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, Zyra e Protokollit, nga e hëna–të premte, ora 08:30–17:00, ose nëpërmjet postës elektronike, në adresën: info@kpk.al, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

NJOFTIM

Nr. 3026/3, datë 28.7.2022

PËR SHPALLJEN E NJË VENDI VAKANT PËR POZICIONIN E SPECIALISTIT TË SEKRETARISË GJYQËSORE NË KOMISIONIN E PAVARUR TË KUALIFIKIMIT ME AFAT 6 DERI NË 12 MUJ

Në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar, që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Specialistit të Sekretarisë Gjyqësore në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: III-b.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) të zotërojnë diplomë të arsimit të lartë në Drejtësi;

b) të kenë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;

c) të kenë të paktën një vit përvojë pune në profesion.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t'u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015;

- Ndaj tyre të mos jetë nisur procedim penal, të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale;

- Ndaj tyre të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore,

e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t'u përshtatur e për të punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;

2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;

3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune) (originale ose të noterizuara);

4. Dëshmi penaliteti;

5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

6. Çdo dokumentacion tjetër, që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda datës 31 gusht 2022, pranë Institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, Zyra e Protokollit, nga e hëna–të premte ora 08:30–17:00, ose nëpërmjet postës elektronike, në adresën: info@kpk.al, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

NJOFTIM

Nr. 3026/4, datë 28.7.2022

PËR RISHPALLJEN E NJË VENDI VAKANT PËR POZICIONIN E SPECIALISTIT TË FINANCË- PROKURIMEVE NË KOMISIONIN E PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit rishpall 1 vend pune në pozicionin Specialistit të Financë-Prokurimeve, me kategori page III-b.

Kandidati duhet të plotësojë këto kriteret:

- të zotërojnë diplomë master në shkenca ekonomike;

- të ketë eksperiencë dhe përvojë në fushën e prokurimeve publike, jo më pak se 1 vit;

- të ketë njohuri të mira kompjuterike në përdorimin e paketës *Microsoft Office*, si dhe të sistemit të prokurimit elektronik SPE;

- Njohuria e gjuhës angleze përbën vlerë të shtuar.

**Kushte të përgjithshme:**

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t'u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015;

- Ndaj tyre të mos jetë nisur procedim penal, të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale;

- Ndaj tyre të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t'u përshtatur e për të punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

- Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;
- Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;

- Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune) (origjinale ose të noterizuara);

- Dëshmi penaliteti;

- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

- Çdo dokumentacion tjetër, që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në

trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim. Aplikimet duhet të dorëzohen brenda datës 31.8.2022, pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në adresën: Rruga e Kavajës, ish-godina e "Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve", Tiranë, Zyra e Protokollit, nga e hëna–të premte, ora 08:30–17:00, ose nëpërmjet postës elektronike, në adresën: info@kpk.al, që konfirmon marrjen e aplikimit përkatës.

NJOFTIM

Nr. 14832, datë 2.8.2022

**PËR SHITJE ME ANKAND TË
PRONËS SHTETËRORE NË
ADMINISTRIM TË
SHOQËRISË "VEFA" SHPK**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes", të ndryshuar, kreu III, shpall për shitje me VAM fillestar, si më poshtë:

1. Në pronësi të shoqërisë "Vefa" administrim sh.p.k.

Nr.	Emërtimi	Vlera fillestare e ankandit në lek	Zhvillimi i ankandit		
			Data	Ora	Vendi
1	Benz Mercedes me targa AA486AV	35 964	31.8.2022	11:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin, si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare në origjinal, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit në lek, për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e

vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrues brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave: www.financa.gov.al.

**KËRKESË**

Nr. 1195, datë 3.8.2022

**PËR MARRJEN ME QIRA TË
AMBIENTEVE PËR NEVOJA TË
SISTEMIMIT TË PUNONJËSVE TË
KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT**

I. Kriteret ligjore që duhet të plotësojnë ofertuesit:

1. Kërkesë e ofertuesit për pjesëmarrje në konkurrim;
2. Të jenë titullarë të ligjshëm të pronës, të vërtetuar me certifikatë pronësie, lëshuar nga ASHK-ja, shoqëruar me kartelën e pasurisë, hartën treguese të pronës dhe gentplanin;
3. Vërtetim hipotekar që prona nuk është në sekuestro dhe është e lirë nga çdo barrë hipotekare apo detyrim tjetër ligjor, lëshuar nga ASHK-ja;
4. Vërtetim nga FSHU-ja që nuk ka detyrime të pashlyera dhe kopje të kontratës së furnizimit të energjisë elektrike;
5. Vërtetim nga UKT-ja që nuk ka detyrime të pashlyera dhe kopje të kontratës së furnizimit nga ujësjellës-kanalizimet;
6. Vërtetim që ofertuesi nuk është në ndjekje penale apo në proces gjyqësor;
7. Nëse është tregtar/shoqëri tregtare duhet të paraqesë edhe:

a) NIPT/NUIS, certifikata e regjistrimit dhe ekstrati historik i regjistrimit të subjektit që vërteton se ka status aktiv;

b) vërtetim nga tatim-taksat që nuk ka detyrime të pashlyera;

c) vërtetim që nuk ka sigurime shoqërore të pashlyera nga *e-Sigurime*;

d) vërtetim nga institucionet përkatëse, që subjekti apo përfaqësuesi ligjor i tij nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk është në proces gjyqësor në lidhje me aktivitetin;

e) në ofertën e tij subjekti i interesuar, duhet të japë të dhëna të sakta të personit të kontaktit;

8. Vetëdeklarim që ofertuesi nuk është në konflikt interesi me Kolegjin e Posaçëm të Apelit;

9. Vetëdeklarim për plotësimin e të gjitha kriterëve ligjore dhe kërkesave specifike të ambienteve që kërkohen nga Kolegji i Posaçëm i Apelit;

10. Kopje ID-je e titullarit të pronës/ambienteve;

11. Vërtetim të numrit të llogarisë bankare në një nga bankat e nivelit të dytë në RSH;

12. Ofertë me shkrim e çmimit të qirasë së ambienteve në muaj (veç kërkesave të tjera, oferta të jetë e nënshkruar nga administratori ose pronari i ambientit dhe të përmbajë të dhënat, sipas tabelës më poshtë):

Nr.	Emri dhe NIPT-i i subjektit	Përshkrimi	Sasia	Sip. totale në m ²	Çmimi pa TVSH (në lek)	Çmimi me TVSH (në lek)
1		Ambient me qira				

13. Oferta fituese do të jetë oferta me çmimin më të ulët (oferta ekonomisht më e favorshme), e cila plotëson të gjitha kriteret ligjore dhe kërkesat e përcaktuara në njoftimin për marrjen e ambienteve me qira për zyra, për punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelit;

14. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti ose të dokumenteve të rreme e të pasakta konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Kërkesat specifike të ambienteve objekt qiramarrjeje:

1. Ambient për zyra me sipërfaqe totale 100 m²–150 m², ku duhet të përfshijë të paktën 3 ambiente

për zyra dhe 1 tualet (të kompletuar me pajisjet hidrosanitare dhe pajisjet për ujë të ngrohtë);

2. Ambientet duhet të kenë të instaluar sistem vëzhgimi me kamera në hyrje të tyre;

3. Ambientet duhet të kenë furnizim me ujë dhe energji elektrike 24/7 dhe të jenë të pajisura me matës të dedikuar të ujit dhe energjisë elektrike;

4. Ambientet duhet të kenë sistem kondicionimi të instaluar dhe plotësisht funksional;

5. Ambientet duhet të kenë rrjet interneti të instaluar, si dhe rrjetin e prizave të energjisë elektrike, për çdo post pune;

6. Ambientet duhet të jenë të përfunduara me dyer, dritare, të lyera dhe të gatshme/të lira për t'u shfrytëzuar nga qiramarrësi. Dera kryesore hyrëse në



këto ambiente duhet të jetë me konstruksion metalik;

7. Ambientet duhet të jenë të pozicionuara brenda hapësirës që kufizohet nga veriu me rrugën “Myslym Shyri” dhe me rrugën “Abdi Toptani”; nga perëndimi me rrugën “Sami Frashëri”; në lindje me rrugën “George W. Bush” dhe me Rrugën e Elbasanit; në jug nga rruga “Abdyl Frashëri” dhe nga rruga “Dervish Hima”.

8. Ambientet duhet të jenë boshe dhe të lira; dorëzimi i objektit do të bëhet brenda 5 (pesë) ditëve pune nga njoftimi për lidhje kontrate.

9. Ofertuesi duhet të përcaktojë çmimin (oferta ekonomike), vlerën mujore të qirasë për një muaj, duke përfshirë të gjitha detyrimet tatimore, sipas legjislacionit në fuqi.

10. Pagesa e qirasë do bëhet çdo muaj në llogarinë në lek të qiradhënësit, brenda datës që palët do të bien dakord në kontratën me shkrim, kundrejt lëshimit të faturës tatimore elektronike për subjektet tregtare. Në rast se qiradhënësi është individ dhe nuk mund të lëshojë faturë tatimore, pagesa e detyrimeve do të kryhet nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për taksat dhe

tatimet dhe shuma e detyrimeve do t'i zbritet qiradhënësit nga vlera e qirasë.

11. Afati i kontratës së qiradhënies të jetë jo më pak se një vit me të drejtë rinovimi. Afati do të përcaktohet gjithmonë nga qiramarrësi, i cili njofton me shkrim 30 ditë para mbarimit të kontratës qiradhënësin.

12. Detyrimet që lindin nga përdorimi i energjisë elektrike, ujit dhe internetit, gjatë periudhës së vlefshmërisë së Kontratës së qirasë, do të përmbushen nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit.

III. Paraqitja e dokumenteve dhe e ofertës së qirasë së ambienteve:

1. Dorëzimi i dokumenteve dhe i ofertës ekonomike duhet të bëhet brenda datës 17 gusht 2022, ora 16:30, me postë ose dorazi, pranë institucionit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në adresën: bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë.

2. Për çdo komunikim apo sqarim, ofertuesit mund të shkruajnë në adresën elektronike: info@kpa.al.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Laerta Rooze

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqipëtare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Tiranë, 2022